



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024  
ME ZGJEDHJE – SESIONI I  
SKEMA E VLERËSIMIT

Lënda: Histori

VARIANTI B

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	D	C	B	C	D	B	D	D	A
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja e saktë	C	C	A	D	A	C	B	A	B	C

Pyetjet me zhvillim

*Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.*

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje:

- Rilindja italiane dhe evropiane.
- Zbulimet e mëdha gjeografike.
- Reformacioni protestant dhe katolik.
- Iluminizmi.

- 3 pikë** Nëse identifikon tre ngjarje që do të sjellin ndryshime në Evropë në fillimet e historisë së kohëve moderne.  
**2 pikë** Nëse identifikon dy ngjarje që do të sjellin ndryshime në Evropë në fillimet e historisë së kohëve moderne.  
**1 pikë** Nëse identifikon një ngjarjeve që do të sjellë ndryshime në Evropë në fillimet e historisë së kohëve moderne.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 3 pikë

Model përgjigjeje:

- Përfundimi i Luftes së Ftohtë u përcaktua nga gjendja ekonomike të dy superfuqive: SHBA kishte një rënie ekonomike, ndonëse relative, ndërsa BS ishte zhytur në një krizë të thellë ekonomike. Në këtë mënyrë gara e armatimeve nuk mund të zhvillohej.
- Ndryshimet e thella që bëri Gorbaçov në politikën e jashtme, sidomos për dhënien fund të garës së armatimeve dhe ndërhyrjes ushtarake në vendet e tjera.
- Shpërbërja e BS dhe Bllokut komunist luajti rol vendimtar në përfundimin e Luftës së Ftohtë.
- Zëvendësimi i modelit bipolar (BS dhe SHBA) të krijuar gjatë Luftës së Ftohtë me modelin multipolar.
- Rënia e Murit të Berlinit, më 9 nëntor 1989, shënoi simbolikisht fundin e Luftës së Ftohtë.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse analizon tre faktorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë.  
**2 pikë** Nëse analizon dy faktorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë.  
**1 pikë** Nëse analizon një faktorë që çoi në përfundimin e Luftës së Ftohtë.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 23 3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Administratë – u krijua një administratë shqiptare, bashkëpunëtore me pushtetin e huaj.
- Ekonomi – u krye bashkimi doganor midis dy vendeve dhe në Shqipëri vërshoi kapitali italian.
- Pavarësisë si shtet – Shqipëria e humbi pavarësinë e saj dhe u kthye në një provincë italiane.

- 3 pikë** Nëse përcakton pasojat e pushtimit italian në Shqipëri në të treja aspektet.  
**2 pikë** Nëse përcakton pasojat e pushtimit italian në Shqipëri në dy aspekte.  
**1 pikë** Nëse përcakton pasojat e pushtimit italian në Shqipëri në një aspekt.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 24 3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Traktatet e paqes duhet të jenë të hapura dhe jo të fshehta.
- Liri e plotë lundrimi në oqean dhe zona neutrale në dete, si në kohë paqes dhe në kohë lufte.
- Armatimet duhet të mbahen në nivelet më të ulëta të mundshme.
- Të krijohet një organizatë e përgjithshme e kombeve për ruajtjen dhe sigurimin e paqes.
- Të respektohet parimi i vetvendosjes së kombeve për të ardhmen e tyre.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse evidenton tri parime të përgjithshme të paraqitura në programin prej 14 pikash të presidentit Wilson.  
**2 pikë** Nëse evidenton dy parime të përgjithshme të paraqitura në programin prej 14 pikash të presidentit Wilson.  
**1 pikë** Nëse evidenton një parim të përgjithshëm të paraqitur në programin prej 14 pikash të presidentit Wilson.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 25 3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**a) 1 pikë**

Monarki feudale e centralizuar.

- 1 pikë** Nëse gjen saktë formën e qeverisjes.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**b) 1 pikë**

Greqishtja do të jetë gjuha zyrtare.

- 1 pikë** Nëse gjen saktë gjuhën zyrtare.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**c) 1 pikë**

Besimi i krishterë ortodoks.

- 1 pikë** Nëse gjen saktë besimin fetar.  
**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

## Pyetja 26

### Model përgjigjeje:

#### a) 1 pikë

Në fund të dy luftërave:

- » shteti që dolil i fuqishëm ekonomikisht ishte SHBA.
- » Evropa u mëkëmb ekonomikisht nga ndihma ekonomike amerikane.
- » shteti që përcakttoi fundin dhe fituesin e luftërave është SHBA-ja.
- » në arenën ndërkombëtare u krijuan organizata botërore paqeruajtëse: Lidhja e Kombeve dhe OKB-ja.
- » Gjermania u pa si shkaktare e tyre dhe u morën masa ndëshkimore ndaj saj.

**1 pikë** Nëse evidenton një moment të ngjashëm të zhvillimeve ndërkombëtare pas të dy luftërave botërore.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

#### b) 3 pikë

Pas Luftës së Parë Botërore	Pas Luftës së Dytë Botërore
a) Rusia nuk do të jetë vend fitues edhe pse ishte aleate me fituesit. Ajo del nga lufta pa mbarua ajo.	a) Bashkimi Sovjetik do të jete fitues i saj dhe do të ndikojë në zhvillimet e mëvonshme ndërkombëtare.
b) Superfuqia e vetme në botë ishte SHBA.	b) Bota kishte dy superfuqi: SHBA dhe BS.
c) Gjermania do të ndëshkohet territorialisht, financiarisht dhe ushtarakisht.	c) Gjermania do të ndëshkohet me copëtim në katër zona pushtimi mes katër aleatëve.
d) Lidhja e Kombeve nuk do të kryejë me sukses funksionin për ruajtjen e paqes në botë.	d) OKB do të jetë e organizuar dhe e strukturuar mirë duke kryer shumë mirë funksionin e saj.
e) Lidhja e Kombeve do të lejojë fillimin e një lufte të re.	e) OKB nuk do të lejojë që Lufta e Ftohtë të shndërrohet në një konflikt të armatosur, por vetëm garë në të gjitha aspektet.
f) Triumfuan sistemet totalitare, si: nazizmi dhe fashizmi.	f) U hartuan politika ndërkombëtare për denazistifikimin dhe defashistizimin e botës.
g) Etj.	g) Etj.

**3 pikë** Nëse evidenton tre ndryshime në zhvillimet ndërkombëtare pas të dy luftërave botërore.

**2 pikë** Nëse evidenton dy ndryshime në zhvillimet ndërkombëtare pas të dy luftërave botërore.

**1 pikë** Nëse evidenton një ndryshim në zhvillimet ndërkombëtare pas të dy luftërave botërore.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

## Pyetja 27

### Model përgjigjeje:

#### a) 2 pikë

Të përbashkëta:

Të dy Statutet:

- sanksiononin shtetin laik.
- sanksiononin ndarjen e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.
- trajtonin te drejtat dhe liritë e qytetarëve në Shqipëri.

**2 pikë** Nëse evidenton dy të përbashkëta midis dy Statuteve shqiptare të v. 1925 dhe v.1928.

**1 pikë** Nëse evidenton një të përbashkët midis dy Statuteve shqiptare të v. 1925 dhe v.1928.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

**b) 1 pikë**

- Sipas Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare (1925), Shqipëria shpallej republikë parlamentare, ndërsa sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare (1928), Shqipëria u shpall "Mbretëri demokratike parlamentare dhe trashëgimore".
- Sipas Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare (1925), parlamenti përbëhej nga dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Deputetëve, ndërsa sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare (1928) Senati u suprimua dhe në parlament mbeti vetëm Dhoma e Deputetëve.
- Sipas Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare (1925), presidenti ishte njëkohësisht dhe kryetari i qeverisë, ndërsa sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare (1928), mbreti nuk ishte edhe kryetari i qeverisë.

**1 pikë** Nëse evidenton një të veçantë midis dy Statuteve shqiptare të v. 1925 dhe v.1928.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 28****Model përgjigjeje:**

- Bënte të qartë shkëputjen e kolonive amerikane nga Britania, shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit të ri të pavarur të SHBA-së.
- Hodhi bazën e qeverisjes konstitucionaliste liberale.
- Riafirmonte të drejtat dhe liritë e individit sipas Xh. Lokut.
- Riafirmonte qeverisjen e kufizuar.

**3 pikë** Nëse përcakton tre nga parimet e Deklaratës së Pavarësisë të vitit 1776 në Amerikën e Veriut.

**2 pikë** Nëse përcakton dy nga parimet e Deklaratës së Pavarësisë të vitit 1776 në Amerikën e Veriut.

**1 pikë** Nëse përcakton një parim të Deklaratës së Pavarësisë të vitit 1776 në Amerikën e Veriut.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 29 3 pikë****Model përgjigjeje:**

- Lejimi i pluralizmit politik.
- Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes ekonomike në vend.
- Lirimi i të burgosurve politikë.
- Heqja e simboleve komuniste.
- Ndryshimi i programeve mësimore.
- Etj.

**3 pikë** Nëse përcakton tri kërkesa kryesore të protestuesve në Lëvizjen e Studentëve të Dhjetorit 1990.

**2 pikë** Nëse përcakton dy kërkesa kryesore të protestuesve në Lëvizjen e Studentëve të Dhjetorit 1990.

**1 pikë** Nëse përcakton një kërkesë të protestuesve në Lëvizjen e Studentëve të Dhjetorit 1990.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 30 3 pikë****Model përgjigjeje:**

- Dënimi në proporcion me rëndësinë e shkeljes ligjore të kryer.
- Konfiskimi i pronës private kundrejt një shpërblimi të drejtë.
- Nuk ka dënim të pambështetur mbi prova dhe dëshmi.
- Proces i drejtë gjykimi për cilindo.

**3 pikë** Nëse identifikon tri të drejta që Magna Carta i jepte anglezëve.

**2 pikë** Nëse identifikon dy të drejta që Magna Carta i jepte anglezëve.

**1 pikë** Nëse identifikon një të drejtë që Magna Carta i jepte anglezëve.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 31** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Vendosi rregullin dhe qetësinë në Pashallëk.
- Ndoqi politikën e tolerancës fetare për katolikët.
- Mori në mbrojtje klerin katolik.
- Nxiti prodhimin zejtar duke përkrahur zejtarët.
- Luftoi piraterinë në det.
- U njohu privilegje vetëqeverisëse krahinave malore.
- Mori shumë malësorë në shërbimin ushtarak.
- Zgjodhi në drejtim njerëz të aftë dhe me integritet.
- Mori nga sanxhaku i Dukagjinit, Lezhën dhe Zadrimën.
- Rriti ndikimin e tij në Mirditë, Durrës e Tiranë.
- Etj.

**3 pikë** Nëse rendit tri arritje të Mehmet pashë Bushatllit në krye të Pashallëkut të Shkodrës.

**2 pikë** Nëse rendit dy arritje të Mehmet pashë Bushatllit në krye të Pashallëkut të Shkodrës.

**1 pikë** Nëse rendit një arritje të Mehmet pashë Bushatllit në krye të Pashallëkut të Shkodrës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 32** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Ndihma e përfituar nëpërmjet Planit Marshall.
- Ekzistenca e një fuqie punëtore të kualifikuar dhe të disiplinuar.
- Shfrytëzimi i kapaciteteve industriale të paprekura nga lufta.
- Risetë teknologjike (Revolucioni III tekniko-shkencor).
- Hapat e para të procesit të integritimit evropian.
- Politikat ekonomike qeveritare në drejtimin e duhur.
- Ekzistenca në përgjithësi e stabilitetit politik.

**3 pikë** Nëse përcakton tri nga arsyet e zhvillimit ekonomik në shtetet e Bllokut Perëndimor pas Luftës II Botërore.

**2 pikë** Nëse përcakton dy nga arsyet e zhvillimit ekonomik në shtetet e Bllokut Perëndimor pas Luftës II Botërore.

**1 pikë** Nëse përcakton një arsye të zhvillimit ekonomik në shtetet e Bllokut Perëndimor pas Luftës II Botërore.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 33** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Në aspektin fetar, ilirët, duke qenë pjesë e Perandorisë Romake, pranuan krishtërimin që në shek. I. kur Roma vetë akoma nuk e kishte pranuar. Krishtërimi në Iliri i takon kohëve apostolike kur apostulli Shën Pal do të kalonte nëpër perandori duke përdorur rrugën Egnatia dhe ilirët do të konvertoheshin në të krishterë përpara se romakët ta pranonin krishtërimin.
- Në aspektin gjuhësor, ilirët do të shkruajnë gjuhën e tyre me alfabetin latin. Gjuha ilire ishte degë e veçantë e gjuhëve të vjetra indoevropiane, por ishte gjuhë vetëm e folur. Për këtë arsye do të huazojnë alfabetin latin për ta shkruar atë.
- Në aspektin arkitektonik u vu re ndikim në stilin e ndërtimit të objekteve me karakter social, politik, fetar. Gjithashtu përdorimi i harkut në ndërtimin e objekteve të ndryshme ishte një risi e huazuar nga latinët. Në objektet fetare përmendim bazilikat dhe mozaikët me të cilat ato zbukuroheshin, etj.

- 3 pikë** Nëse shpjegon tre elemente të reja që u vunë re në kulturën ilire nën sundimin romak.
- 2 pikë** Nëse shpjegon dy elemente të reja që u vunë re në kulturën ilire nën sundimin romak.
- 1 pikë** Nëse shpjegon një element të ri që u vu re në kulturën ilire nën sundimin romak.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.
-